

UNOSEK/PR/15

E premte, 15 shtator, 2006

Beogradi, Prishtina diskutojnë më tej krijimin e komunave të reja me popullatë shumicë serbe në Kosovë

Vjenë – Sot delegacionet nga Beogradi dhe Prishtina edhe më tej kanë diskutuar për decentralizimin, si pjesë e bisedimeve direkte që mbahen nën patronatin e të dërguarit të posaçëm të Sekretarit të KB për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, Martti Ahtisaari. Zëvendësi i të dërguarit të posaçëm, Albert Rohan ka kryesuar me takimin, që për temë kishte krijimin e komunave të reja me popullatë shumicë serbe në Kosovë.

Zëvendësi i të dërguarit të posaçëm, takimin e sotëm e vlerësoi si “përmbajtësor dhe të përqëndruar në temë, me një polemikë minimale”. Mirëpo, ai tha se, nuk kishte përparim të vërtetë, ‘nuk kishte lëvizje të rëndësishme nga cilado palë’, duke shtuar se “disa nga koncesionet e bëra gjatë takimit të grupeve të ekspertëve nga ana e delegacionit serb, tani ishin kushtëzuar me pranimin e kërkesave të tjera’.

Përkitazi me Mitrovicën, të dyja palët kanë mbajtur qëndrimet e veta, tha Z. Rohan. Ai sqaroi se, preokupimi kryesor i delegacionit të Prishtinës ishte që të ketë “një qytet me dy komuna”, me një bord obligativ të përbashkët, përgjegjës për shërbimet lokale, ndërsa delegacioni serb propozoi bashkimin e pjesës veriore të Mitrovicës me Zveçanin dhe që bordi të jetë vetëm si një institucion vullnetar.

Në konkludimin e tij, Z. Rohan tha se perspektiva e përparimit në këto biseda sa vjen e dobësohet. Gjatë përgjigjes në pyetjen e një gazetari, ai nënvizoi se, “ne jemi duke iu afruar momentit kur vetëm përmes bisedimeve nuk do të mund të arrijmë qëllimin. Ne mund të vazhdojmë me bisedime edhe për dhjetë vjet të tjera dhe të mos ketë ndryshime fare”, ndërsa duhet pasur parasysh faktin se UNOSEK-u funksionon në kuadër të hapsirës kohore të dhënë nga Grupi i kontaktit.

Zëvendësi i të dërguarit të posaçëm shtoi se “megjithatë, UNOSEK-u do të vazhdojë së punuari në këto çështje teknike dhe ne do të mundohemi që të gjejmë zgjidhjet – përmes mënyrave të cilat mund të jenë të dobishme – zgjidhje që janë të drejta, të cilat janë të arsyeshme dhe funksionale.”